



**ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM  
OPŠTINSKA KANCELARIJA ZA ZAJEDNICE I POVRATAK  
OFFICE FOR COMMUNITIES AND RETURN**

KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY OF RAHOVEC  
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL COUNCIL  
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 411 Nr. i flet./Br.shr./No.pg 136  
Data e miratimit 5 / 9 / 23  
RAHOVEC / ORAHOVAC

**RAPORTI 3 MUJOR (Janar -Mars)**

Ne këtë raport të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim , janë pasqyruar aktivitetet dhe angazhimet që janë kryer në prejdhën Janar –Mars 2023 .

Fokusi kryesor i zhvillimit të aktiviteteve , janë realizuar konform planifikimeve të bëra sipas planit vjetor të punës, përkatesisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë tërë vitit 2023.

**SYNIMI KRYESOR I ZKKK-SË PËR VITIN 2023 :**

- ☐ Përmisimi i gjendjës së Komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Rahovecit nga të gjithë segmentet;
- ☐ Përmiresimin e infrastruktures
- ☐ Zhvillimi i aktiviteteve Kulturore , Arsimore dhe Edukative posaqërisht promovimi vlerave demokracisë, diversitetit etnik , dhe mbrojtjës së të drejtave të njeriut dhe komuniteteve ;
- ☐ Fushata sensibilizuese në çështje jetike ,( mbi rëndësin e arsimit ) Arsim ,( hixhenës , vaksinimit të rregullt për fëmijë ) Shëndetësi , ( parandalimit të dhunës në familje ) Barazi gjinore (bahskëpunimit ndëretnik) Multikulturalizëm.
- ☐ Ngritjen ,zhvillimin profesional dhe mbështetja me e start up bizneseve për komunitetit jo-shumicë në Komunën e Rahovecit.

## **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME :**

- Përmiresimi i gjenjës së komuniteteve jo-shumicë , të zhvendosurve , dhe të riatdhesuarve në të gjitha çështjet jetike .
- Implementimi i planit të punës , strategjive të nivelit qendror ( për komunitete , riatdhesuar ,zhvendosur) , planëve të veprimit .
- Promovimi I kulturës dhe identitetit të komuniteteve jo-shumicë.
- Monitorimi I projekteve Edukative (përfshi funksionalizimin e qendrave të komunitetve , procesit mësimor ) .
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore ku jetojnë komunitetet ( kanalizim , kubzim, ndërtim, renovim)
- Zhvillimi dhe bashkëpunimi i aktiviteteve të shumta jashtë planifikimeve të planit të punës ;
- Bashkëpunimi me komunitetin dhe me OJQ-të , ;
- Integrimi në procesin edukativo-arsimor i të gjithë fëmijëve të të gjitha komuniteteve pa dallim;
- Aktivitetet që fuqizojnë multikulturalizimin , bashkjetesën ndëretnike , sportive , kulturore dhe edukative.

## ARSIM :

**INFORMATË :** Në Komunën e Rahovecit , vijnë mësimin rreth 100 nxënës nga Komuniteti Rom , Ashkali dhe Egjiptian .Rom 3 , Ashkali 77,Egjiptian 20 ( 6 prej tyre në shkollat të mesme ) në të gjitha shkollat me sistem të Republikës së Kosovës .

**Program Paralel Lagja e eperm & fsh.Hoqe e Madhe /Komuniteti Serbë :**

Në të dy shkollat fillore : 80 Nxënës , në të dy shkollat të Mesme 14 Nxënës , dhe në të dy Qerdhe 33

Total : 127 Nxënës .

- Shefi i ZKKK-së ka realizuar takim koordinues me drejtorin e DKA-se , mbi procesin e funksionalizimit të programit “QENDRA MËSIMORE ME BAZË NË KOMUNITET/shkollë” –që pritet të funksionalizohet në Shkollën “GËZIM HAMZA-PIKTORI” .
- Shefi i ZKKK-së ka realizuar takim me zyrtaret e MASHT-it gjegjësisht zyrtaren znj.NAZAN SAFQI nga njesia për çështje të komuniteteve , mbi fillimin e procedurave për mundësinë e akreditimit të Qendrës .
- Shefi i ZKKK-së bashkë me drejtorin e DKA-se , ka dhënë një pëlqim fillestar për mundësinë e menaxhimit Qendres për organizatën BALLKAN SUNFLOËER , dhe është në pritje të koordinimit për funksionalizim .
- Është realizuar trajnimi për ngritjen e kapacitetve në arsimin gjithë përfshirës “INCLUDE” në kuadër të Këshillit të Europës”.



## SHËNDETËSI & MIRQENJE SOCIALE

Duke marrë parasysh rëndësinë , rolin , dhe çështjet që kanë të bëjnë me përmisimin e gjengjës sëkomuniteteve përmes sektorit të shëndetësisë dhe mirqenjes sociale .

Në bashkëpunim me akteret e ndryshëm të nivelit qendror , local OJQ-të dhe organizatatndërmkombëtare , janë realizuar këto aktivitete :



- UNICEF-&BALLKAN SUNFLOWER në bashkëpunim me ZKKK-në , vazhdojnë procesin e vaksinimit të rregullt të fëmijeve dhe fushatave sensibilizuese me gra të komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian mbi rëndësinë e ushqyshmerisë përmes gjidhenjës.

- Fushata vetëdijesuese për vaksinim të rregullt të fëmijeve

0-10 vjeq - Realizuar nga programi UNICEF-& BALLKAN SUNFLOWER.

- Fushata Vetedijesuese me te riatdhesuarit dhe komunitetet jo-shumicë mbi mbrojtjen nga sëmundjetkronike si : Diabeti , Hipertensioni , Semundjet Kronike , si dhe rëndësia e gjidhënjes për fëmijet Realizuar nga programi I UNICEF-& BALLKAN SUNFLOWER.
- ZKKK , në bashkëpunim me OJQ-VORAE ka bërë inspektimin e punimeve për përfituesit e renovimit të shtëpive .

## RIATDHESIM

- Është mbajtur komisioni për riatdhesim dhe janë shqyrtuar 4 kërkesa të të riatdhesuarve.
- Komisioni për riatdhesim ka dalë në vizitë zyrtare për verifikimin e gjendjes dhe banimit të 4 të riatdhesuarve , dhe ka rekomanduar vazhdimin e procedurave sipas udhimit administrative në fuqi .
- Janë lëshuar për nevoja personale të të riatdhesuarve mbi 5 vertetime (dëshmi që janë të riathdhesuar)



## KTHIMI I QËNDRUSHËM

- Janë trajnuar zyrtarisht 2 zyrtaret e ZKKK-së , mbi menaxhimin e databazës dheshfrytezim të sistemit për kthim të qëndrushëm .
- Është në procedurën në Kuvend dhe është aprovuar –Plani i Veprimit për Kthim të Qëndrushëm 2023-2025.
- Është mbajtur takim më përfaqësuesit e UNHCR dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim , mbi gjendjen dhe procesin e kthimit , si dhe mundësisë për vazhdimin e programit RRK-6 në të ardhmen.

## SIGURI

- Pjesmarrja e stafit të ZKKK-së në 2 takime të Këshillit për Siguri në Bashkësi
- Janë realizuar takime të rregullta me KFOR- Austriak mbi gjendjen e sigurisë së Komuniteteve jo-shumicë .

## STRATEGJITË /PLANE TË VEPRIMIT .

- Draftimi i Strategjisë Komunale për zhvillimin e pozitës së Komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Rahovecit ( Rom , Ashkali , Egjiptian dhe Serbë) , mbështetur nga OSCE .
- Draftimi i Planit të Veprimit për avancimin e pozitës së komunitetit Rom dhe Ashkali 2023-26.
- Plani komunal për Riintegrimin dhe Integrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe të Huajve 2023 – 2025



## KOMITETI PËR KOMUNITETE



- Pjesmarrja e antarëve të ZKKK-së në 2 takime të Komitetin për Komunitete.
- Vizita në Lagjet dhe vendbanimet e komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Rahovecit dhe Fshatrat.
- Raportimi periodik i ZKKK-së për realizimin e disa projekteve në banim .

## PJESËMARRJA NË AKTIVITETE , TRAJNIME DHE KONFERENCA

- Shefi i ZKKK-së ka realizuar 3 Takime të rregullta me Staffin , me qëllim të inplementimit të planit të punës 2023 ,kordinimit dhe ndarjen e vazhdushme të obligimeve , me qëllim të menaxhimit ditor të aktiviteteve .



- Shefi i ZKKK-së ka marrë pjesë në trajnimin 2 ditore me nxënësat e shkollave të mesme (RAHOVEC, fsh,Krushe e Madhe , Ratkoc) kunder dhunës në familje të organizuar nga Shtëpia e Sigurtë në Gjakovë .
- Pakicat në Kosovën e pavarur" me rastin e 15-vjetorit të Pavarësisë.

- Shefi I ZKKK-së ka realizuar takime javore me përfaqësuesit e OSCE-së , me qëllim të forcimit të rolit të ZKKK-së, mbështetjes së politikave komunale, zbatueshmërisë së dokumenteve strategjike në favor të komuniteteve .



- Shefi i ZKKK-së ka marrë pjesë në aktivitetet sensibilizuese të organizuar nga SHL Kosova dhe HAREA mbi dhunën në familje .

- Shefi I ZKKK-së bashkë me Nënkrjetarin e Komunës është takuar me Ministrin për Komunitete dhe Kthim z.Nenad Rasic.
- Shefi i ZKKK-së ka takuar znj.Elisabeth Goëin , për mundësinë e mbështetjeve me projektet kapitale në venbanimet e komuniteteve jo-shumicë.
- Trajnim për Menaxhimin e Granteve,



- Procesi i monitorimit dhe raportimit mbi ecurine e Strategjisë së Komuniteteve Rom dhe Ashkali .





## PLANI I PUNËS PËR 3 MUAJ (PRILL-QERSHOR).

- FINALIZIMI DHE APROVIMI I PLANIT PËR AVANCIMIN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI 2023-2026.
- FINALIZIMI DHE APROVIMI I PLANIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN DHE INTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE TË HUAJVE 2023 – 2025
- INPLEMENTIMI I PLANIT TË QËNDRUSHËM PËR PËRSONAT E ZHVENDOSUR 2023-2025.
- REALIZIMI I TRAJNIMIT PËR TËRINJET E KOMUNITETVE JO-SHUMICË “ DIVERSITETI YNË, PASURIA VENDIT”.
- VIZITA NË LAGJE DHE VENDBANIMET E KOMUNITETEVE ( fsh. Celine , Krushe , Ratkoc , Dobidol , Cifllak )
- RENOVIMI I NDERTESSES SE ZYRËS NË FSH.HOQË E MADHE .
- AKREDITIMI I QENDRES ME BAZË NË KOMUNITET
- APLIKIMI NE THIRRJET E HAPURA PER PROJEKTET E KOMUNITETEVE .
- MBAJTJA E RREGULLT E TAKIMEVE ME STAFIN E ZKKK-SE
- MBAJTJA E RREGULLT E TAKIMEVE PER INPLEMENTIMIN E STRATEGJISE-KOMITETI NDËRVEPRUES .
- DALJA NE TEREN BASHKE ME ANTARET E KOMITETIT PËR KOMUNITETE.
- FUSHATA SENSIBILIZUESE NË REGJISTRIMIN E FËMIJEVE NË KLASË TË PARË.
- MANIFESTIMI I DITËVE NACIONALE ( të komuniteteve ) .
- NDARJA E MIRËNJOHJEVE /DEKORATAVE PËR BASHKËPUNTORET .
- MBËSHTETJA ME BURSA DHE ASISTIMI NE KOMPLETIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR TË RINJET E KOMUNITETEVE .
- FORCIMI I KAPACITETEVE TË STAFIT NË TRAJNIMIN PROFESIONAL PËR INPLEMENTIMIT TË LIGJIT AZIL DHE TË HUAJ .
- FUSHATA NDËRGJEGJËSUESE PËR RENDËSIN E REGJISTRIMIT CIVIL.
- VIZITA NË INSTUTICIONE QEVERTITARE, ORGANIZATA LOKALE , DHE NDËRKOMBETARE.

Lendrit QELI, PhD Can.  
Shef i ZKKK-s



05.04.2023 Rahovec